



Akti Normativ nr.9, datë 25.03.2020

Në Fletoren Zyrtare 50, u publikua Akti Normativ nr. 9 i Këshillit të Ministrave, datë 25.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19" (**Akti Normativ 9**).

Akti Normativ 9 në nenin 3 të tij "Masat e veçanta dhe efektet në fushën e veprimtarisë gjyqësore", parashikon sa më poshtë:

1. Seancat gjyqësore në çështjet administrative, civile dhe penale, të planifikuara pranë të gjitha gjykatave, shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.
2. Nga data e hyrjes së fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 pezullohen afatet për ngritjen e padive, për paraqitjen e ankimeve si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, sipas parashikimeve në këtë akt normativ. Kur afatet fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.

Rregullat e mësipërme, nuk zbatohen në këto raste:

- a. Në çështjet administrative, me objekt gjykimin e masave të sigurimit të padisë, në rast se gjykata vlerëson se shqyrtimi pas afatit të përcaktuar në këtë akt normativ, mund të shkaktojë një dëm të rëndë e të pariparueshëm për palët.
- b. Në çështjet familjare, me objekt gjykimi kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë dhe birësimin, masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim, si dhe në ato çështje civile në të cilat, përjashtimisht, gjykata vlerëson se shqyrtimi i vonuar i tyre mund të shkaktojë dëm të rëndë e të pariparueshëm për palët.
- c. Në çështjet penale, që lidhen me vleftësimin e arrestit në flagrancë ose ndalimit, caktimin, verifikimin e kushteve e të kriterëve të caktimit dhe nevojat e sigurimit, zëvendësimin, revokimin, bashkimin ose shuarjen e masave të sigurimit të "arrestit në burg" ose të "arrestit në shtëpi", kur të arrestuarit, të pandehurit ose mbrojtësit e tyre kërkojnë që të vijohet me shqyrtimin e tyre, si dhe në çështjet penale që lidhen me caktimin e masës së sigurimit pasuror "sekuestro preventive".
- d. Në çështjet penale, në të cilat afatet e kohëzgjatjes maksimale të paraburgimit, sipas pikës 6, të nenit 263, të Kodit të Procedurës Penale, mbarojnë gjatë periudhës së pezullimit.



- e. Në çështjet penale të një natyre urgjente, për shkak të nevojës së sigurimit të provës, sipas nenit 316, të Kodit të Procedurës Penale (*urgjenca vlerësohet nga gjykata që shqyrton çështjen*).
- f. Në çështjet penale në ngarkim të të miturve në konflikt me ligjin, kur ndaj tyre është zbatuar masa e arrestit apo e ndalimit, sipas nenit 15, të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.
- g. Në çdo çështje tjetër penale ku i pandehuri është i paraburgosur ose është duke vuajtur dënimin me burgim, në rast se i pandehuri ose mbrojtësi i tij kërkojnë vazhdimin e gjykimit.

Sipas nenit 4, pjesëmarrja e personave të dënuar apo me masë sigurimi “arrest në burg”, si dhe e përfaqësuesve ligjorë të tyre, në të gjitha seancat gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë, sigurohet, atje ku është e mundur, nëpërmjet ndërlidhjes audiovizive në distancë, duke përdorur programe kompjuterike të përshtatshme për këtë qëllim.

Akti Normativ nr. 9 hyn në fuqi menjëherë.



Normative Act no.9, dated 25.03.2020

On the official Gazette no. 50, is published the Normative Act of the Council of Ministers no. 9, dated 25.03.2020 *"On special measures in the field of judicial activity during the infection period caused by Covid-19"* (**Normative Act 9**).

The Normative Act 9, under article "Special measures and effects in the field of judicial activity", inter alia provides for the following:

1. Court hearings on administrative, civil and criminal cases, scheduled in all courts, are postponed until the end of the state of epidemic emergency caused by the proliferation of COVID-19.
2. From the date of entry into force of this normative act until the end of the epidemic emergency caused by the proliferation of COVID-19, the deadlines for filing lawsuits and submission of appeals are suspended as well as any procedural action in administrative, civil, and criminal cases, as provided in this normative act. In case deadlines start during the suspension period, they are postponed until the end of the epidemic emergency.

The above rules do not apply in the following cases:

- a. In administrative cases, having as object an injunction measure, if the court evaluates that the examination after the term provided for in this normative act may cause serious and irreparable damage to the parties.
- b. In family law cases, having as object, the due care, obligations and observance of juvenile rights, custody and adoption, safeguards against domestic violence, parental responsibility, custody and alimony, and civil cases for which the court considers that delayed hearings may cause serious and irreparable damage to the parties.
- c. In criminal cases related to the validation of arrests due to blazing offences or detention, the assignment, verification of the terms and conditions for the application of a precautionary measure, the replacement, revocation or termination of the precautionary measures of "imprisonment" or "house arrest", when arrestees, defendants or their defense counsel request to be examined, as well as in criminal cases related to the imposition of a precautionary measure of "preventive sequestration".
- d. In criminal cases, where the maximum term of detention under article 263/6 of the Criminal Procedure Code expires during the period of suspension.



- e. In criminal cases of an urgent nature, due to the need of pre-trial admission of evidence under article 316 of the Code of Criminal Procedure (*the urgency is assessed by the court, examining the case*).
- f. In criminal cases involving juveniles, where the precautionary measure of arrest or detention under article 15 of the Juvenile Criminal Justice Code has been applied to them.
- g. In any other criminal case where the defendant is in precautionary detention or is serving a sentence of imprisonment, if the defendant or his lawyer request a continuation of the trial.

As per article 4, during the term of the epidemic emergency, the participation in the trial of sentenced individuals, individuals under the precautionary measure of “imprisonment” and their lawyers, should be assured, when possible, through online video connection with the use of appropriate computer programs.

Normative Act no. 9 shall enter into force immediately.